

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Companies**  
**Trepça Deoničarsko Društvo**

Nr. 3390 Data: 21.04.2026  
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 2778 të datës 26.05.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stantërg, Trepça Sh.A me datë 21.04.2026 publikon këtë:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Titulli i pozitës së punës:</b>	Agjustator
<b>Koeficienti/Paga:</b>	650€ bruto
<b>Nr. i kërkuar:</b>	2
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
<b>Data e njoftimit:</b>	21.04.2026
<b>Afati për aplikim:</b>	22.04.2026 – 06.05.2026
<b>Institucioni:</b>	Ndërmarrja “Trepça Sh.A.”
<b>Njësia Biznesore:</b>	Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
<b>Vendi i punës:</b>	Stan Tërg

## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Kryen detyrat dhe punët e mirëmbajtjes makinerike në repart;
- Menjanojnë prishjet dhe mangësit në repart në kuadër të aftësive të veta;
- Ka për detyrë që me ndërgjegje dhe profesionalisht ti menjanojë prishjet dhe mangësit në pajisje si dhe t'i zbatoj urdhërat e udhëheqësit;
- Obligohet që ti përdorë mjetet mbrojtëse në punë;
- I përgjigjet brigadierit dhe kryepunëtorit të mirëmbajtjes makinerike;
- Kryen edhe të gjitha punët tjera me urdhër të udhëheqësit;

## 2. Kriteret e përgjithshme

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

## 3. Kriteret e veçanta

---

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme;
- Duhet të ketë së paku 2 vite përvojë pune profesionale.

## 4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

---

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për

vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

## 5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim- 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

## 6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

## 7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokollit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Industrial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00.

## 8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A  
Kryesheti Ekzekutiv  
Faton Ahmeti

